



RREGULLORJA E FUNKSIONIMIT TE KESHILLIT DREJTUES TE FEDERATËS SHQIPTARE TË BILARDOS DHE SNOOKERIT (FSHBS)

1. Dispozitat e Përgjithshme

- 1.1 Këshilli Drejtues është organi drejtues ekzekutiv i Federatës Shqiptare të Bilardos dhe Snookerit (FSHBS).
- 1.2 Këshilli përbëhet nga 7 anëtarë me këtë strukturë: Presidenti, Zëvendës Presidenti dhe 5 anëtarë të tjerë.
- 1.3 Anëtarët e Këshillit zgjidhen në përputhje me Statutin e Federatës.

2. Thirrja dhe Zhvillimi i Mbledhjeve

- 2.1 Këshilli Drejtues mbledhet jo më pak se 6 herë në vit dhe sa herë konsiderohet e nevojshme për çështje të veçanta.
- 2.2 Mbledhjet thirren nga Presidenti ose nga shumica e anëtarëve të Këshillit Drejtues.
- 2.3 Njoftimi për mbledhje u dërgohet anëtarëve jo më vonë se 7 ditë para zhvillimit të mbledhjes, përveç rasteve urgjente ose atyre me fuqi madhore.
- 2.4 Mbledhja e Asamblesë thirret nga Këshilli Drejtues me miratimin e 2/3 të anëtarëve të tij.

3. Kompetencat e Këshillit Drejtues

- 3.1 Këshilli Drejtues ka përgjegjësinë të menaxhojë dhe drejtojë punët e FSHBS-së në përputhje me Statutin dhe siguron zbatimin e tij.
- 3.2 Këshilli emëron dhe shkarkon Sekretarin e Përgjithshëm me propozim të Presidentit ose të më shumë se gjysmës së anëtarëve të Këshillit.
- 3.3 Këshilli zgjedh midis anëtarëve të tij Zëvendës Presidentin.
- 3.4 Përgatit dhe mban Asamblenë e Përgjithshme të zakonshme dhe të jashtëzakonshme.
- 3.5 Rishikon dhe miraton pasqyrat financiare dhe harton buxhetet e FSHBS-së.
- 3.6 Harton raportin për aktivitetet e Federatës.
- 3.7 Emëron, pezullon ose shkarkon anëtarët e Komiteteve të përhershme ose të përkohshme të Federatës.
- 3.8 Harton rregullore dhe i paraqet ato për miratim në Asamblenë e Përgjithshme.
- 3.9 Propozon në Asamblenë e Përgjithshme ndryshime statutore dhe akte të tjera të miratuara nga Asambleja.
- 3.10 Këshilli Drejtues miraton kalendarin e aktiviteteve të programuara për çdo vit.
- 3.11 Propozon rendin e ditës dhe propozimet konkrete për t'u diskutuar në Asamblenë e Përgjithshme.



4. Rregullat e Punës së Këshillit Drejtues

4.1 Rregullat e punës së anëtarëve të Këshillit përcaktohen në një rregullore të veçantë funksionimi, e cila miratohet nga Asambleja e Përgjithshme me shumicë votash.

4.2 Mbledhjet zhvillohen sipas një axhende të përcaktuar paraprakisht.

5. Kërkesat për Anëtarët e Këshillit Drejtues

5.1 Anëtarët e Këshillit Drejtues duhet të plotësojnë këto kushte:

- a. Të jenë shtetas shqiptarë me banim në Shqipëri;
- b. Të kenë arsim të lartë;
- c. Të jenë nën moshën 70 vjeç në datën e mbajtjes së Asamblesë së Përgjithshme Zgjedhore;
- d. Të kenë certifikim sipas testeve ndërkombëtare në nivelin të paktën B1 të gjuhës angleze;
- e. Të kenë figurë të pastër morale;
- f. Të mos jenë të dënuar nga organet e drejtësisë shqiptare ose të huaja;
- g. Të mos jenë njëkohësisht trajnerë, gjyqtarë, vëzhgues të Federatës, ose anëtarë të ndonjë federate tjetër sportive në Shqipëri;
- h. Të kenë aftësi të spikatura në menaxhim, ekonomi, drejtësi, sport etj.

5.2 Anëtarët e Asamblesë që propozojnë një kandidat për Këshillin Drejtues nuk duhet të jenë të pezulluar.

6. Mandati dhe Shkarkimi i Anëtarëve

6.1 Anëtarët e Këshillit Drejtues mund të shkarkohen para përfundimit të mandatit të tyre me shumicë votash të Asamblesë së Përgjithshme.

6.2 Në rast përfundimi të parakohshëm të mandatit të një anëtari, Asambleja e Përgjithshme zgjedh një pasardhës për periudhën e mbetur të mandatit.

6.3 Në rast se një anëtar i Këshillit Drejtues mungon 3 herë në mbledhje, anëtarët e tjerë kanë të drejtën e propozimit në Asamble për përjashtim të tij.

7. Vendimmarrja

7.1 Vendimet e Këshillit Drejtues merren me shumicë votash të të gjithë anëtarëve të saj.

7.2 Këshilli mund të vendosë t'i drejtohet Asamblesë së Përgjithshme për marrjen e vendimeve për çështje specifike.

8. Konflikti i Interesit

8.1 Asnjë anëtar i Këshillit Drejtues nuk i lejohet të marrë pjesë në diskutim ose në vendimmarrje për çështje ku ka interes ekonomik të drejtpërdrejtë ose të tërthortë.